



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.922 Prot.

Tiranë, më 07 .08. 2023

V E N D I M

Nr.155 , Datë 07_.08. 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”², të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 199 Regj, datë 16.12.2022, paraqitur nga znj. E.Xh, ku pretendohet diskriminim për shkak të ankimit në gjykatë dhe diskriminimin në formën e viktimizimit, nga ana e z. A.K, Drejtor i Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova”, Shkodër.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në informacionin e parashtruar në formularin e ankesës, rezulton se ankuesja E.Xh ka përfunduar Shkollën e Mesme Artistike për specialitetin piano në vitin 1991. Në vijim, në vitin 2000, ankuesja ka përfunduar studimet e larta pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore, në degën Histori –Gjeografi.

Me vendimin nr. 26, datë 20.01.1999, të Drejtorisë Arsimore Shkodër, znj. Xh, e cila kishte mbajtur më parë pozicionin e mësueses provizore, emërohet në pozicionin e mësueses së pianos në Shkollën e Mesme Artistike “Preke Jakova”, Shkodër. Në vendim theksohet fakti se ankuesja ka arsim të mesëm për muzikë dhe arsim të lartë për histori-gjeografi.

Në vitin 2015, nëpërmjet Vendimit (pa numër), datë 16.09.2015, “*Për emërim definitiv (kalim në profil)*” të Drejtorit të Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova”, znj. E.Xh është emëruar në mësuese definitive e lëndës Histori-Gjeografi, sipas profilit të saj. Në këtë vendim, ankuesja, e cila më parë ka mbajtur pozicionin e mësueses së pianos, është konsideruar jashtë profilit të saj. Vendimi i sipërcituar është dërguar për njohje titullarit të DAR Shkodër.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Znj. Xh e ka kundërshtuar vendimin e sipërcituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit (pa numër), datë 16.09.2015, “*Për emërim definitiv (kalim në profil)*” të Drejtorit të shkollës, duke e konsideruar në kapërcim të kompetencave të tij, në kundërshtim me procedurën dhe në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të ligjit, kthimin e palëve në gjendjen e mëparëshme, etj. Në cilësinë e palës së paditur ka qenë Shkolla e Mesme Artistike “Preke Jakova” dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Shkodër.

Nëpërmjet Vendimit nr. 1320 (5559), datë 26.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është vendosur pranimi pjesërisht i padisë së ankueses dhe është bërë konstatimi i pavlefshmërisë së vendimit pa numër, të datës 16.09.2015, të Drejtorit të Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova”, Shkodër, lidhur me emërimin e ankueses në një detyrë tjetër nga ajo e mëparshme, si dhe përcaktohet detyrimi e paditësve të paguajnë diferencat e pagës për kohën nga momenti i ndryshimit të vendit të punës e në vazhdim, si dhe detyrimin e Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova” dhe DAR Shkodër t’i paguajnë znj. Xh dëmshpërblim në masën e tre pagave mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit dhe 2 paga mujore për mosrespektim të procedurës.

Ankuesja e ka apeluar vendimin e sipërcituar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Me vendimin nr. 163, datë 04.04.2022, Gjykata e Apelit Shkodër ka lënë në fuqi vendimin e sipërcituar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përveç ndryshimit që ka bërë në pikën 2, të tij, lidhur me detyrimin e palëve të paditura t’i paguajnë paditëses E.Xh një dëmshpërblim për zgjidhje të menjëherëshme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës (pavlefshmeri absolute të vendimit) në masën e 3 (tre) pagave mujore.

Ankuesja shprehet se punon ende pranë Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova”, Shkodër, në profilin e mësueses së histori-gjeografisë, me orë të reduktuara, ndërkohë që vendimi gjyqësor i formës së prerë për ta rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës, si mësuese pianoje nuk zbatohet nga drejtori i shkollës, megjithëse ky pozicion është vakant.

Për sa më sipër, ankuesja sqaron se Drejtori i Shkollës së Mesme Artistike nuk e zbaton vendimin gjyqësor, duke e diskriminuar për shkak të ankimit në gjykatë dhe pretendon gjithashtu diskriminimin në formën e viktimizimit.

Znj. Xh kërkon nga KMD ndalimin e diskriminimit, zbatimin e vendimit të gjykatës dhe vendosjen në pozicionin e mëparshëm të punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 52 prot., datë 10.01.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga z. A.K, Drejtor i Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova”, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Nëpërmjet kësaj shkrese Komisioneri vuri në dijeni të ankesës Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër (në vijim ZVAP Shkodër).

1.1 Me shkresën nr. 7 prot., datë 23.01.2023³, z. A.K, Drejtor i Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova”, ktheu përgjigje duke parashtruar ndër të tjera:

Znj. E.Xh ka kryer arsimin e mesëm profesional pranë Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova” në specialitetin “Piano” në vitin 1990-1991. Më pas ka kryer arsimin e lartë pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, Dega Histori-Gjeografi, ku edhe është diplomuar me titullin “Mësuese e Historisë dhe Gjeografisë”. Znj. E.Xh ka filluar punë në Shkollën e Mesme Artistike “Preke Jakova” më datë 01.02.1998.

Me urdhër nr.363, datë 16.09.2014 “Për caktimin e nivelit arsimor të mësuesit në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, pika 1, është urdhëruar që të gjithë mësuesit që janë në marrëdhënie pune me kohë të plotë apo të pjesshme të zotërojnë diplomë universitare në fushën e edukimit ose të njëvlershme me të, sipas përcaktimeve të nenit 57 dhe 72. Duke qenë se znj. E.Xh zotëronte diplomë të arsimit të lartë në profilin Histori-Gjeografi, me vendimin pa numër, datë 16.09.2015, nr.174/12 prot., të nxjerrë nga drejtoria e shkollës, është vendosur kalimi i znj. E.Xh si mësuese e lëndës Histori-Gjeografi, sipas profilit të saj, duke qenë se u krijua mundësia e një vendi vakant në këtë profil (me daljen në pension të znj.L.S). Me vendimin e datës 16.09.2015, nr.174/12

³ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.52/1 prot., datë 25.01.2023.

prot., znj. E.Xh është caktuar të kalojë në profilin përkatës sepse nuk disponon arsimin përkatës në degën piano sipas ligjit nr. 69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë periudhës që znj. E.Xh ka punuar në Shkollën e Mesme Artistike “Preke Jakova” nuk ka marrë masa disiplinore.

Shkolla e Mesme Artistike “Preke Jakova” informon se, nuk ka llogari bankare për kryerjen e procedurave përmbarimore dhe kjo procedurë kryhet nga Zyra Vendore Arsimore Shkodër, pra shkolla nuk është institucioni i cili bën ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, pasi pagesat dhe gjithë trajtimi ekonomik bëhet nga Zyra Vendore Arsimore Shkodër.

2. Me anë të *e-malit* të datës 01.02.2023, ankuesja ka dërguar prapësimet e saj në lidhje me shkresën e sipërcituar të, duke parashtruar ndër të tjera se:

Drejtoria e Shkollës “Preke Jakova” ka vepruar në kundërshtim me urdhrin nr.363, datë 16.09.2014 të Ministrisë së Arsimit dhe se gjykata e ka konsideruar vendimin e drejtorit për largimin e ankueses nga puna si një vendim *nul* i cili nuk ka asnjë forcë ligjore. Ankuesja pretendon se, ka zvarritje të pajustificuara për të zbatuar vendimin e Gjykatës së Apelit të datës 04.04.2022, për sa i përket kalimit të saj në pozicionin e mësimdhënies piano. Sipas ankueses, drejtori i shkollës të gjitha veprimet e pajustificuara dhe kalimin e kompetencave ia faturon ZVAP Shkodër. Ankuesja pretendon se vazhdon të diskriminohet si për pozicionin e punës ashtu edhe në lidhje me moszbatimin e plotë të pikës 2, të vendimit të Gjykatës së Apelit të datës 04.04.2022, duke i shkaktuar asaj dëm financiar.

3. Me shkresën nr. 293/1 prot, datë 02.02.2023⁴, ZVAP Shkodër, ka kthyer përgjigje duke informuar ndër të tjera Komisionerin se:

Znj. E.Xh ka kryer arsimin e mesëm profesional pranë Shkollës së mesme Artistike “Preke Jakova” në specialitetin “Piano” në vitin akademik 1990-1991. Më pas ka kryer arsimin e lartë pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, Dega Histori-Gjeografi, ku edhe është diplomuar me titullin “Mësuese e Historisë dhe Gjeografisë”. Znj. E.Xh ka filluar punë në Drejtorinë Arsimore Rajonale Shkodër, Shkolla e Mesme Artistike “Preke Jakova” më datë 01.02.1998, si mësuese pianoje. Me urdhërin nr 363, datë 16.09.2014 “Për caktimin e nivelit arsimor të mësuesit në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, pika 1, është urdhëruar që të gjithë mësuesit që janë në marrëdhënie pune me kohë të plotë apo të pjesshme të zotërojnë diplomë universitare në fushën e edukimit ose të njëvlershme me të, sipas përcaktimeve të nenit 57 dhe 72. Duke qenë se znj. E.Xh zotëronte diplomë të arsimit të lartë në profilin Histori-Gjeografi, me vendimin pa numër, datë 16.09.2015, nr.174/12 prot., të nxjerrë nga drejtori i Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova” është vendosur kalimi i znj. E.Xh si mësuese e lëndës Histori-Gjeografi, sipas profilit të saj. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, ankuesja E.Xh i është drejtuar gjykatës, duke kërkuar konstatimin absolutisht të pavlefshëm të vendimit të

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.52/4 prot., datë 06.02.2023.

datës 16.09.2015 dhe zgjidhjen e marrëdhënies së punës pa shkaqe të arsyeshme dhe të justifikuar duke kërkuar shpërblimet përkatëse. Me vendimin nr.1320, datë 26.11.2018, Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë. Me vendimin gjyqësor nr.163, datë 04.04.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër, i cili është protokolluar pranë ZVAP Shkodër me nr.1789 prot., datë 19.05.2022, gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.1320, datë 26.12.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me një ndryshim në pikën 2, të këtij vendimi. Vendimi nr.163, datë 04.04.2022, i Gjykatës së Apelit Shkodër nuk ka marrë formë të prerë pasi ZVAP Shkodër ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë. ZVAP Shkodër ka bërë ekzekutimin e pagave të znj. E.Xh, por nuk mund të bëjë kalimin në pozicionin mësuese pianoje siç kërkon ankuesja pa patur një vendim të formës së prerë nga Gjykata e Lartë.

Në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*”, Zyra Vendore Arsimore ka kryer procedurat përkatëse për çeljen e fondit për ekzekutimin e detyrimit por nuk mund të bëhet pagesa pa marrë konfirmim nga MAS. Pas miratimit të ministrisë, ZVAP Shkodër ka bërë ekzekutimin vullnetar të vendimit nr.163, datë 04.04.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër në masën 171.180 lekë (3 paga). Pagesa ka kaluar në llogarinë e znj. E.Xh me urdhër-shpenzimin nr.133, datë 08.07.2022. ZVAP Shkodër është njohur me shkresën nr.277 Dkp.Prot, datë 07.09.2022, protokolluar pranë ZVAP me nr.3578 prot., datë 09.09.2022 me lënë “*Lajmërim për ekzekutim vullnetar*”, ku kërkohet pagesa e 5 (pesë) pagave. Në përgjigje të këtij njoftimi, ZVAP Shkodër ka kthyer përgjigje duke kërkuar informacion për përllogaritjen e shumës. Në vijim ZVAP Shkodër është njoftuar nga Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, znj. E. M., për vendimin për kalim në ekzekutimin e detyruar me shkresën nr.277/Dkp.Prot, datë 15.09.2022, protokolluar pranë institucionit me nr.3800 prot, datë 19.09.2022.

Nga leximi dhe interpretimi i dispozitivit të dy vendimeve të gjykatës, vendimit të Gjykatës së Apelit dhe vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë rezulton se, ZVAP Shkodër duhet të paguajë 3 paga për mosnjoftim të shkëputjes së kontratës. Nuk mund të jepet masë dy herë për të njëjtin dispozitiv të Kodit të Punës (shkëputje kontrate). Mbështetur në nenin 510 të K.Pr.Civile, titulli ekzekutiv dhe ekzekutimi i vendimit mund të bëhet vetëm në bazë të vendimit të gjykatës. Vendimi i Gjykatës së Apelit nuk shprehet në pjesën e dispozitivit për pagesën e 8 muajve page. Për këtë, është përcjellë në gjykatë për kundërshtime të veprimeve përmbaimore për të cilin nuk kemi një njoftim zyrtar nga gjykata deri tani. Pavarësisht kundërshtimit të veprimeve përmbaimore, ZVAP Shkodër ka bërë kërkesë për çelje fondi me shkresën nr. 3967/2 prot., datë 03.10.2022, në mënyrë që të mos penalizohet ankuesja dhe të përshpejtohen procedurat. ZVAP Shkodër ka qenë në pritje të vendimit të gjykatës për kundërshtimin e veprimeve përmbaimore dhe të miratimit nga ministria të kërkesës për çelje fondi. Me shkresën nr.3219 prot., datë 06.12.2022 (ardhur me *e-mail* dhe protokolluar në institucion me nr.4778 prot datë 06.12.2022) është kërkuar likuidimi i vendimit nga DRAP Lezhë. Shuma e kërkuar është likuiduar me urdhër-shpenzimin nr. 234, datë 13.12.2022.

Znj. E.Xh nuk mund të kalohet në pozicionin mësuese e pianos pa një vendim të formës së prerë dhe duke marrë parasysh që çdo akt administrativ i dalë nga shkolla për kalimin e saj në këtë pozicion pune do të ishte në shkelje të ligjit nr. 69/2012 “*Për arsimin parauniversitar në*

Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Mësuesja nuk plotëson kriteret sipas ligjit për të ushtruar profesionin e mësueses së pianos.

Pagesa e znj. E.Xh sipas vendimit gjyqësor për 5 paga, është bërë në dhjetor të vitit 2022 për shkak të vendimit dhe miratimit të procedurave të miratimit të pagesës. Duke qenë se dispozitivi ka qenë i paqartë për zbatimin e tij, ZVAP Shkodër ka bërë pagesën vetëm në masën e përcaktuar në dispozitiv. ZVAP Shkodër ka detyrimin që të marrë miratimin paraprak nga organet e prokurorisë para se të bëjë çdo pagesë dhe nuk mund të disponojë lirisht me të ardhurat e shtetit. Të detyruar nga procedura dhe ligji do të ishin ndjekur të njëjtat hapa si për këdo. Në total ZVAP Shkodër i ka paguar znj. E.Xh, 8 paga.

4. Me anë të *e-mailit* datë 17.02.2023, ankuesja ka dërguar prapësimet e saj në lidhje me shkresën e sipërcituar të, duke parashtruar ndër të tjera se:

Dispozitivi i vendimit të formës së prerë të gjykatës, është shumë i qartë, ku është vendosur lënia në fuqi e vendimit të shkallës së parë, por me një ndryshim në pikën 2 të vendimit. Sipas ankueses, ZVAP Shkodër i bën një interpretim të gabuar vendimit të formës së prerë të gjykatës. Emërimi i pavlefshëm dhe i pajustificuar i ankueses në një pozicion tjetër i konstatuar nga gjykata, është bërë pa pëlqimin e saj, dhe e ka vendosur atë të kushte të disfavorshme, duke i ndryshuar kushtet e punës dhe pagën. Në lidhje me pretendimin për nxjerrjen e akteve nga drejtoria e shkollës të ngritur nga ZVAP Shkodër, ankuesja shprehet se është i pabazuar, pasi shkolla nuk është organi kompetent, por ZVAP Shkodër, e cila ka kompetencë për të nxjerrë aktin sipas vendimit të gjykatës. Mosveprimi nga ana e ZVAP Shkodër dhe mos nxjerrja e një udhëzimi në afatin e caktuar që nga vendimi i gjykatës i formës së prerë, ka sjellë konflikte në punë dhe diskriminim. Ankuesja thekson gjithashtu se, pretendimi i ZVAP Shkodër në lidhje me gjendjen arsimore është i pabazuar, pasi ajo është mësuese e punësuar në bazë të kriterëve të ligjit parauniversitar dhe nuk është në kundërshtim me kriteret. Ndryshimi i pozicionit ka sjellë pabarazi, kufizim, parapëlqim dhe diskriminim në pagë jo të barabartë në raport me kolegë të tjerë të cilët kanë të njëjtin kriter arsimor dhe janë në të njëjtat kushte. Ankuesja informon se, padia për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore e bërë nga ZVAP Shkodër është pushuar nga ana e gjykatës.

Ankuesja pretendon gjithashtu se, likuidimet e vendimit gjyqësor nuk janë bërë në afate dhe nuk është cituar shuma që i është kërkuar në bazë të vendimit të gjykatës. ZVAP Shkodër ka detyrimin që të paguajë me pasqyrë financiare e historik likuidimi dhe sipas dokumentacionit të paraqitur nga ZVAP Shkodër rezultojnë problematika me vendimarrjen, si për likuidimin me format financiar dhe atë të ndryshimit të pozicionit. Vendimi i gjykatës së apelit datë 04.04.2022, si nga dëmshpërblimi, ashtu edhe nga konstatimet e pavlefshmërisë, kërkojnë rregullimin në pozicionin e punës. ZVAP Shkodër dhe Drejtoria e Shkollës “Preke Jakova” vazhdojnë në formën e një mohimi e modifikimi të paarsyeshëm duke sjellë diskriminim financiar dhe arsimor.

5. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”*, dhe

për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 21.03.2023.

Seanca dëgjimore e datës 21.03.2023, nuk u zhvillua për shkak të pamundësisë për të marrë pjesë të subjekteve ZVAP Shkodër dhe Drejtorit të Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova”. Për t’i dhënë mundësi palëve për të qenë prezent në seancë dëgjimore, Komisioneri shtyu zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 14.04.2023 ora 11:00.

Seanca dëgjimore e datës 14.04.2023, u zhvillua me pjesëmarrjen e ankueses znj. E.Xh, e cila ishte personalisht prezent, z. A.K, Drejtor i Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova” dhe ZVAP Shkodër, e përfaqësuar nga znj. Y. D, sipas autorizimit nr.1299/1 prot., datë 12.04.2023.

Gjatë seancës dëgjimore ankuesja theksoi se, është diskriminuar nga drejtori i shkollës për shkak të urdhrin të nxjerrë prej tij. Sipas ankueses, një situatë e ngjashme me të sajën ka ndodhur dhe me mësues të tjerë, por këta kanë pranuar vetë dhe kanë firmosur për të ndryshuar kontratën, ndërsa ka mësues të tjerë që ndodhen në të njëjtat kushte me të, pra që japin lëndë profesionale edhe pse kanë arsimin e mesëm profesional. Ankuesja pretendon se shkak i diskriminimit është egoja profesionale dhe paaftësisë së drejtorit të shkollës.

Drejtori i shkollës, prapësoi pretendimet e ankueses duke parashtruar se, ai ka zbatuar ligjin. Atij i është kërkuar nga ZVA që të vendosë në dispozicion emrat e personelit që nuk ishin në profil. Ankuesja nuk kishte shkallën e parë të kualifikimit, ndërsa mësuesit e tjerë që kanë vazhduar kanë patur shkallën e parë të kualifikimit. Meqënëse në shkollë në atë kohë një mësuese doli në pension dhe ankuesja kishte arsimin e lartë në Histori-Gjeografi, u bë sistemimi i saj në profil dhe me ngarkesë të plotë, ndërsa 3 mësues të tjerë u larguan nga puna. Nëse nuk do të lirohej vendi edhe ankuesja do të largohej nga puna. Ankuesja deklaroi se kishte marrë 8 paga por nuk kishte marrë diferencat që nga 2015 kur iu ndryshua pozicioni.

Në lidhje me pretendimi e ankueses për moszbatimin e gjykatës, drejtori i shkollës, pretendon se, gjykata nuk e ka udhëruar një gjë të tillë, por ka konstatuar shkelje në procedurë dhe njoftim. Nëse gjykata do të kishte urdhëruar rikthimin e ankueses në punë, do të ishin konsultuar me ZVAP dhe DRAP dhe emërimi i ankueses do të kryeje nga ana e tij. Drejtori i shkollës shpjegoi se, për momentin nuk kishte kërkesë mësues piano dhe nëse do të kishte nevojë do t’i bënte kërkesë ZVA. Mësuesit e brendshëm nuk mund t’i kalonte për të mbuluar orët e pianos. Procedura kërkon që ai t’i drejtohet ZVA dhe është ky institucion i cili ndjek procedurat dhe përcjell emrin përkatës.

Përfaqësuesja e ZVAP Shkodër deklaroi gjatë seancës dëgjimore se, institucioni ka zbatuar kërkesat ligjore duke bërë çeljen e fondit, por nuk mund të bëhet kalimi pa miratimin e ministrisë. Në lidhje me emërimin, aktualisht ato bëhen me Portal. Bëhen kërkesat nga drejtorët dhe më pas njoftohet vendi vakant. Pas aplikimeve bëhet përzgjedhja sipas kërkesave.

Ankuesja prapësoi pretendimin e përfaqësueses së ZVAP Shkodër, duke pretenduar se ajo nuk futej nëpërmjet Portalit pasi kishte një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe sistemimi realizohej

nëpërmjet lëvizjes paralele. Drejtori i shkollës e kundërshtoi këtë pretendim të ankueses, duke parashtruar se, nuk kemi të bëjmë me lëvizje paralele, por me kalim në profil. Aktualisht nuk ka më kalim në profil sepse nuk ka më mësues jashtë profilit dhe kjo fazë ka përfunduar. Aktualisht ankuesja është e sistemuar në profilin e saj.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesja E.Xh, është e datëlindjes 03.03.1973 dhe banon në qytetin e Shkodrës. Ankuesja ka kryer arsimin e mesëm profesional pranë Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova” në specialitetin “Piano” për vitin akademik 1990-1991. Më pas ankuesja ka kryer arsimin e lartë pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, Dega Histori-Gjeografi, ku dhe është diplomuar me titullin “Mësuese e Historisë dhe Gjeografisë” në vitin 2000.

Rezulton se, ankuesja ka filluar punë pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër, Shkolla e Mesme Artistike “Preke Jakova” më datë 01.02.1998. Ankuesja ka vazhduar të punojë në këtë pozicion pune deri më datë 16.09.2015, datë kur ankueses i është ndërprerë marrëdhënia e punës si “mësuese e pianos” dhe është kaluar në një pozicion tjetër dhe profil tjetër pune si mësuese gjeografie, në të njëjtën shkollë. Konkretisht me vendimin (pa numër) datë 16.09.2015, nr.174/12 prot., të nxjerrë nga Drejtori i Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova” është vendosur, emërimi definitiv i ankueses E.Xh, si mësuese e Lëndës Histori-Gjeografi”, sipas profilit të saj. Referuar përmbajtjes së këtij vendimi, rezulton se kjo lëvizje është emërtuar si “kalim në profil”. Bazuar në vendimin e drejtorit të shkollës, midis palëve ka nisur një marrëdhënie e re pune, në një profil të ndryshëm pune, me marrëdhënie të ndryshme financiare, ku ankuesja fillonte punë si mësuese Histori-Gjeografie.

Duke mos qenë dakort me këtë vendim, ankuesja E.Xh i është drejtuar gjykatës, duke pretenduar se vendimi i marrë nga drejtori i shkollës ishte absolutisht i pavlefshëm dhe se gjykata duhet t’u kthente atë në pozicionin e mëparshëm të punës, duke i dhënë dhe dëmshpërblimet përkatëse sipas Kodit të Punës.

Me vendimin nr. 1320, datë 26.11.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka vendosur:

“

- *Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë së paditëses E. T. Xh.*
- *Konstatimin e pavlefshmërisë të vendimit pa numër të datës 16.09.2015 të Drejtorit të Shkollës së mesme Artistike “Prek Jakova”, Shkodër lidhur me emërimin në një detyrë tjetër nga ajo e mëparshme duke i paguar paditëses E. T. Xh diferencat e pagës për kohën nga ndryshimi i vendit të punës e në vazhdim. Diferenca e pagës të merret ajo e para vendimit të datës 16.09.2015 me pagën e sotme.*

- *Detyrimin e palës së paditur Shkolla e Mesme Artistike “Prenk Jakova”, Shkodër dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Shkodër të paguajnë paditëses E. Tren. Xh dëmshpërblim për mosrespektimin e afateve të njoftimit në masën e 3 pagave mujore, dhe dëmshpërblim për mosrespektim të procedurës në masën e 2 pagave mujore.*
- *Si pagë referuese do të merret paga që ekzistonte përpara ndryshimit të pozicionit të punës.*
.....”

Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila me vendimin nr.163, datë 04.04.2022 ka vendosur:

“Lënien në fuqi të vendimit nr.1320 (5559), datë 26.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me këtë ndryshim në pikën 2 të tij, i cili formulohet në këtë mënyrë:

- *Detyrimin e palëve të paditura t’i paguajnë paditëses E.Xh një dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës (pavlefshmëri absolute e vendimit) në masën e 3 (tre) pagave mujore.”*

Ankuesja E.Xh ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën nr. 199, datë 16.12.2022 duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të ankimit në gjykatë dhe diskriminim në formën e viktimizimit, nga ana e z. A.K, Drejtor i Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova”, Shkodër.

- **Në lidhje me pretendimin e ankueses se është diskriminuar nga vendimi (pa numër) datë 16.09.2015, i nxjerrë nga Drejtori i Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova”, nëpërmjet të cilit është vendosur kalimi i ankueses nga detyra si mësuese pianoje në pozicionin tjetër si mësuese e Lëndës Histori – Gjeografi.**

Bazuar në faktet dhe provat e administruara rezulton se, diskriminimi i pretenduar nga ankuesja ka ndodhur në datën 16.09.2015, kur nëpërmjet vendimit pa numër të marrë në këtë datë, nga Drejtori i Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova”, ankueses i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për detyrën e “mësuese piano” dhe është kaluar në një detyrë tjetër, atë të mësueses për Lëndën Histori-Gjeografi. Bazuar në aktet e administruara rezulton e provuar se, ankuesja ka marrë dijeni për diskriminimin e pretenduar pasi e ka bërë vendimin objekt të shqyrtimit gjyqësor duke paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër padinë e cila është regjistruar pranë kësaj gjykate me nr. regj. themeltar 1477, dt. regj. 03.09.2018.

Bazuar në nenin 33, pika 4, të LMD, parashikohet rastet kur ankesa nuk mund të pranohet për shqyrtim nga ana e Komisionerit. Në germën “dh, të pikës 4, të nenit 33, parashikohet shprehimisht: “4. Ankesa nuk pranohet nëse:dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese.”

Bazuar në faktet dhe provat e administruara rezulton se, diskriminimi i pretenduar nga ankuesja ka ndodhur në datën 16.09.2015, datë kur me vendimin e drejtorit ajo ka kaluar nga pozicioni mësuese pianoje në pozicionin si mësuese e lëndës Histori-Gjeografi. Nga aktet nuk është e mundur që të

përcaktohet se kur ankuesja ka marrë dijëni në lidhje me vendimin e drejtorit të shkollës, por rezulton plotësisht e provuar se, minimalisht ankuesja ka qënë në dijëni në këtij fakti në datën 03.09.2018, datë në të cilën është regjistruar padia e saj pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Ankesa objekt shqyrtimi është paraqitur në datën 16.12.2022.

Sa më sipër rezulton se, ankesa është paraqitur më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit (16.09.2015) dhe më vonë se dy vjet nga marrja dijëni për sjelljen diskriminuese (03.09.2018) dhe për rrjedhojë, në bazë të nenit 33, pika 4, germa “dh” ajo është paraqitur jashtë afateve të parashikuara nga LMD. Në këto kushte dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “dh”, të LMD, Komisioneri arrin në përfundimin se, pretendimi i paraqitur nga ankuesja në kuadër të ankesës objekt shqyrtimi dhe që ka lidhje me momentin e ndërrimit të pozicionit të punës nga mësuese pianoje në mësuese e lëndës Histori-Gjeografi, sipas vendimit të drejtorit të shkollës të datës 16.09.2015, nuk mund të pranohet për shqyrtim nga Komisioneri, pasi është paraqitur jashtë afateve ligjore dhe rrjedhimisht ky pretendimin nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të shqyrtimit nga ana e Komisionerit.

- **Në lidhje me pretendimin e ankueses për moszbatimin e vendimit gjyqësor.**

Në ankesën e paraqitur prej saj pranë Komisionerit, ankuesja pretendon gjithashtu se është diskriminuar për shkak të moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe konkretisht vendimit nr. 1320 (5559), datë 26.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i cili ka marrë formë të prerë me vendimin nr. 163, datë 04.04.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër. Ankuesja pretendon se, diskriminimi i pretenduar prej saj ka ndodhur pikërisht në datën 04.04.2022, kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë pas vendimmarrjes nga ana e Gjykatës së Apelit Shkodër. Pretendimi i ankueses për moszbatim të vendimit gjyqësor konsiston në dy momente; *së pari*, ankuesja pretendon se nuk është zbatuar vendimi i gjykatës në lidhje me dëmshpërblimin financiar të dhënë nga gjykata; *së dyti*, ankuesja pretendon se vendimi i gjykatës nuk është zbatuar në lidhje me disponimin që ka bërë kjo gjykatë për rikthimin e saj në vendimin e mëparshëm të punës, si mësuese pianoje.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, ZVAP deklaroi se, vendimi nr.163, datë 04.04.2022, i është komunikuar këtij institucioni në datën 19.05.2022 dhe është protokolluar me nr.1789 prot. Rezulton se, kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër, ZVAP Shkodër ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, por nuk ka ende një vendimarrje nga ana e kësaj gjykate.

Rezultoi e provuar gjatë shqyrtimit se, Shkolla e Mesme Artistike “Preke Jakova” nuk është institucion që ka kompetenca dhe funksione për të realizuar ekzekutimin e detyrimeve financiare që burojnë nga detyrimi për të zbatuar vendimet e gjykatës në lidhje me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesen.

Në bazë të dokumentacionit të administruar, rezulton se, ZVAP Shkodër ka kryer procedurat e mëposhtme për zbatimin e vendimit nr.1320 (5559), datë 26.11.2018 të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Shkodër, i ndryshuar me vendimit nr.163, datë 04.04.2022, të Gjykatës së Apelit Shkodër (vetëm për sa i përket pikës 2 të vendimit):

ZVAP Shkodër ka filluar procedurat për ekzekutimin në mënyrë vullnetare të vendimit të gjykatës dhe nga ana e saj janë kryer procedurat përkatëse për çeljen e fondit për ekzekutimin e detyrimit. Me shkresën nr. 3545/1 prot., datë 28.06.2022, me lëndë “Për ndryshime në planin e buxhetit të vitit 2022”, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka dhënë miratimin për ekzekutimin e detyrimit, një miratim ky që është i detyrueshëm në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014 të Ministrit të Financave “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”. Pas miratimit nga ana e MAS, ZVAP Shkodër ka nxjerrë urdhrin nr.123 datë 05.07.2022 “Për likuidimin e detyrimeve sipas vendimit gjyqësor nr.163, datë 04.04.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër”, nëpërmjet të cilit është urdhëruar: “Të bëhet pagesa e vendimit nr. 163, datë 04.04.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër”. Në vijim të urdhrin të nxjerrë nga titullari i ZVAP Shkodër, ka dalë urdhër-shpenzimi nr. 133, datë 08.07.2022, nëpërmjet të cilit ankueses i është paguar shuma prej 171,180 lekë. Rezulton se kjo shumë, pra 171,180 lekë përfaqëson dëmshpërblimin prej 3 paga mujore të dhëna nga gjykata për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës (pika 2 e vendimit nr. 1320, datë 26.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ndryshuar me vendimin nr.163, datë 04.04.2022, të Gjykatës së Apelit Shkodër).

Ankuesja nuk ka qenë dakort dhe ka pretenduar se vendimi i gjykatës nuk është ekzekutuar në mënyrën e duhur. Për të kërkuar ekzekutimin e plotë të vendimit të gjykatës, ankuesja i është drejtuar shërbimit përbarimor privat. Me shkresën nr. 277/Dkp.prot., datë 07.09.2022 “Lajmërim për ekzekutim vullnetar”, përbaruesi gjyqësor privat ka njoftuar ZVAP Shkodër dhe Shkollën e Mesme Artistike “Preke Jakova”, të dy në cilësinë e palëve debitore, se duhet t’i paguanin ankueses një dëmshpërblim në masën e 5 pagave, të përlllogaritura gjithsej në vlerën 285.300 lekë. Në këtë shkresë përbaruesi gjyqësor privat thekson se, ekzekutimi dhe kalimi në llogarinë e ankueses i shumës prej 171,180 lekë, përfaqësonte vetëm ekzekutimin e pikës 2, të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i cili ishte ndryshuar me vendimin e Gjykatës së Apelit, duke anashkaluar pikat e tjera të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të cilat kishin mbetur në fuqi.

Duke pretenduar se, nëpërmjet kalimit në favor të ankueses të shumës prej 171,180 lekë (3 paga) kishte zbatuar vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër, në dispozitivin e të cilit nuk kishte parashikime për 8 paga por 3 paga, ZVAP Shkodër, nuk e zbatoi vullnetarisht kërkesën e paraqitur nga përbaruesi gjyqësor privat. Në vijim, ky i fundit, me shkresën nr. 277/Dkp. prot., datë 15.09.2022, i’u ka komunikuar ZVAP Shkodër dhe Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova” vendimin për kalim në ekzekutim të detyruar. Fillimisht, ZVAP Shkodër kundërshtoi në gjykatë veprimet e përbaruesit gjyqësor. Gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u administrua ndonjë vendimarrje e gjykatës në lidhje me padinë për kundërshtimin e veprimeve përbarimore të paraqitur nga ana e ZVAP Shkodër, ndërsa ankuesja informoi se kjo padi ishte pushuar nga gjykata. Më pas, rezulton se, me shkresën nr. 4778/1 prot., datë 06.12.2022, ZVAP Shkodër ka njoftuar përbaruesin gjyqësor privat se, ishte duke bërë ekzekutimin e vendimit nr. 163, datë 04.04.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Me shkresën nr. 3967/1 prot., datë 03.10.2022, me lëndë “Gjurma e auditit”, ZVAP ka filluar procedurën për çeljen e fondit për ekzekutimin e detyrimit sipas vendimit për kalim në ekzekutim të detyruar të nxjerrë nga përmbaruesi gjyqësor privat. Me shkresën nr. 3219 prot., datë 06.12.2022, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë (DRAP Lezhë), i ka kërkuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, likuidimin e vendimit gjyqësor. Me urdhrin nr.206, datë 12.12.2022 “Për likuidimin e detyrimeve sipas vendimit gjyqësor nr.163, datë 04.04.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër”, të ZVAP Shkodër, është urdhëruar që të bëhet pagesa për vendimin e gjykatës, ndërsa me urdhër shpenzimit nr. 234, datë 13.12.2022, është paguar shuma në vlerën 285.300 lekë, që i korrespondon 5 pagave.

Sa më sipër rezulton se, ankuesja, sikurse deklaroi edhe vetë gjatë seancës dëgjimore, ka përfituar 8 paga dëmshpërblim, në zbatim të vendimit nr.1320, datë 26.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i ndryshuar me vendimin nr.163, datë 04.04.2022, të Gjykatës së Apelit Tiranë (vetëm për sa i përket pikës 2 të vendimit).

Në këto kushte ZVAP Shkodër pretendon se ka ekzekutuar plotësisht detyrimin financiar të vendosur nga gjykata në favor të ankueses, ndërsa kjo e fundit pretendon se duhet të përfitojë edhe diferencat për ndryshimin e pozicionit.

Në bazë të dokumentacionit të administruar konstatohet se, ZVAP ka kaluar në favor të ankueses në muajin korrik 2022, vlerën 171,180 lekë ose 3 pagat e dhëna sipas pikës 2, të vendimit nr. 1320, datë 26.12.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, sipas ndryshimit të vendosur nga vendimi nr. 163, datë 04.04.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër, dhe më pas, nëpërmjet procedurave të ekzekutimit të detyruar të kryera nëpërmjet përmbaruesit gjyqësor privat, ZVAP rezulton të ketë kaluar në favor të ankueses shumë prej 285.300 lekë ose 5 pagat e dhëna sipas pikës 3, të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, të lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër. Pra, rezulton se, në total ankuesja ka përfituar gjithsej 8 paga dhe në këtë mënyrë ZVAP Shkodër ka përmbushur plotësisht detyrimin financiar ndaj ankueses në përputhje me vendimarrjen e gjykatës. Pika 2, e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ku ishte vendosur detyrimi për t’i paguar ankueses diferencat e pagës për kohën nga ndryshimi i vendit të punës e në vazhdim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Shkodër duke vendosur se ankuesja duhet të përfitonte 3 paga dëmshpërblim për për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës (pavlefshmëri absolute e vendimit), dëmshpërblim të cilin ankuesja e ka përfituar.

Në lidhje me pretendimin e ankueses për moszbatimin e vendimit të gjykatës, për sa i përket urdhërimit që ajo ka bërë për të rikthyer ankuesen në vendimin e mëparshëm të punës si mësuese pianoje, në bazë të dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se ky pretendim i ankueses është i pabazuar.

Referuar vendimit nr. 1320 (5559), datë 26.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe vendimit nr. 163, datë 04.04.2022, të Gjykatës së Apelit Shkodër, konstatohet se, gjykata nuk ka urdhëruar ZVAP Shkodër dhe Shkollën e Mesme Artistike “Preke Jakova” që të rikthejnë ankuesen

në vendin e mëparshëm të punës si mësuese pianoje, por i kanë njohur kësaj të fundit vetëm dëmshpërblimin në masën e 8 pagave, për mosrespektim të parashikimeve përkatëse të Kodit të Punës.

Ankuesja rezulton t'i jetë drejtuar Gjykatës së Apelit Shkodër edhe me një kërkesë për plotësimim, sqarim dhe interpretim të vendimit nr.163, datë 04.04.2022, të Gjykatës së Apelit Shkodër. Me vendimin nr. 181, datë 12.09.2022, Gjykata e Apelit Shkodër, ka rrëzuar kërkesën e ankueses. Ndër të tjera Gjykata e Apelit Shkodër arsyeton se: *“.....vendimi gjyqësor është i qartë dhe i plotë në përmbajtjen dhe dispozitivin e tij, dhe nuk ka se çfarë të plotësohet, të sqarohet apo interpretohet në rastin konkret. Nga ana tjetër Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi gjithë pjesën tjetër të vendimit nr. 1320 (5559), datë 26.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në të gjitha konkluzionet e tij, me përjashtim të pikës 2 të dispozitivit e cila rezulton se është ndryshuar dhe formuluar ashtu si edhe është cituar në vendim. Çka do të thotë që në përfundim të këtij gjykimi civil me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit, kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme dhe pagimi i dëmshpërblimeve përkatëse, është pranuar padia vetëm për dëmshpërblimet, ku paditësja E.Xh duhet të përfitojë në total një dëmshpërblim prej 8 muajve pagë, ku si pagë referuese do të merret paga që ekzistonte përpara ndryshimit të pozicionit të punës. Ky disponim i gjykatës është shumë i qartë dhe nuk ka se çfarë të saktësohet apo plotësohet.”*

Përfundimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja E.Xh nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e z. A.K, Drejtor i Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova” dhe Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shkodër, në lidhje me pretendimet e parashtruara në ankesë. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses E.Xh, nga ana e z. A.K, Drejtor i Shkollës së Mesme Artistike “Preke Jakova” dhe Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shkodër.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Çdo shkak tjetër
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim